| <p>arsenit, merkurit, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike, pjesa V e shtojcës V të këtij Udhëzimi Administrativ referohet teknikave referente të modelimit të cilësise së ajrit kur teknika të tilla janë në dispozicion.</p> <p>15. Çdo ndryshim i nevojshëm për të përshtatur dispozitat e këtij neni dhe të pjesës II të Shtojcës II dhe të Shtojcave III deri V të këtij Udhëzimi Administrativ, të progresit shkencor dhe teknik duhet të miratohen në pajtim me procedurën e referuar nga udhëzuesit e Komisionit Evropian, por nuk mund të rezultojë në ndonjë ndryshim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me vlerat e synuara.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b><br/><b>Transmetimi i informatave dhe raportimi</b></p> <p>1. Për zonat dhe aglomeratet ku njëra nga vlerat e synuara të përcaktuara në Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ është tejkaluar, Ministria duhet të përcjellë informatat për:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Listën e zonave dhe aglomerateve;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. Zonat e tejkalimit;</p> | <p>total deposition of arsenic, mercury, cadmium, nickel and polycyclic aromatic hydrocarbons. Part V of Annex V of the Administrative Instruction refers to reference techniques of air quality modeling when such techniques are available.</p> <p>15. Any change necessary to adapt the provisions of this article and of Part II of Annex II and Annexes III - V of this Administrative Instruction on the scientific and technical progress shall be adopted in accordance with the procedure referred to by the European Commission guidelines, but may not result in any change directly or indirectly with the target values.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 6</b><br/><b>Transmission of information and reporting</b></p> <p>1. For zones and agglomerations where one of the target values set out in Annex I of this Administrative Instruction is exceeded, the Ministry shall convey the information to:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. List of zones and agglomeration;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. Excess areas;</p> | <p>deo V Prilogu V, ovog Administrativnog Uputstva referiše se referentnim tehnikama modeliranja kvaliteta vazduha kada su takve tehnike na raspolaganju.</p> <p>15. Svaka promena potrebna radi prilagođavanja odredbi ovog člana i dela II Priloga II i Dodatka III do V ovog Administrativnog Uputstva, naučnog i tehničkog napretka treba se usvojiti u skladu sa procedurom referisanom od uputnika Evropske Komisije, ali ne može rezultirati na neku direktnu ili indirektnu promenu sa ciljnim vrednostima.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 6</b><br/><b>Prenos informacija i izveštavanje</b></p> <p>1. Za područja i aglomeracije gde jedna od ciljnih vrednosti navedenih u Prilogu I ovog Administrativnog Uputstva je prekoračena, Ministarstvo treba da prati informacije za:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Listu područja i aglomeracija;</p> <p style="margin-left: 40px;">1.2. Područja prekoračenja;</p> |
|---|--|--|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>1.3. Vlerat e përqendrimeve të vlerësuara;</p> <p>1.4. Arsyet për tejkalim, dhe në veçanti ndonjë burim që kontribuon në atë;</p> <p>1.5. popullata e ekspozuar një tejkalimi të tillë.</p> <p>2. Ministria raporton për të gjitha të dhënat e vlerësuara në përputhje me nenin 4 të këtij Udhëzimi Administrativ, krijimin e shkembimit reciprok të informatave dhe të dhënave nga rrjetet dhe stacionet individuale duke matur ndotjen e ajrit mjedisor. Informatat transmetohet për çdo vit kalendarik, jo më vonë se 30 shtator të vitit vijues.</p> <p>3. Përveç kërkesave të parashtruara në paragrafin 1 të këtij neni, Ministria gjithashtu duhet të raportojë masat e marra në përputhje me nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>4. Ministria duhet të sigurojë që informatat të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni janë në dispozicion të publikut nëpërmjet mjeteve të përshtatshme si, shtyp, internet si dhe media të tjera lehtësisht të arritshme.</p> | <p>1.3. Concentrations estimated values;</p> <p>1.4. Reasons for the excess, and in particular any source that contributes to it;</p> <p>1.5. population exposed to such an excess.</p> <p>2. Ministry reports for all data assessed in accordance with article 4 of this Administrative Instruction, establishing mutual exchange of information and data from networks and individual stations measuring ambient air pollution. Information is transmitted in each calendar year, no later than 30 September of the following year.</p> <p>3. In addition to the requirements set forth in paragraph 1 of this Article, the Ministry shall also report the measures taken in accordance with Article 3 of this Administrative Instruction.</p> <p>4. The Ministry shall ensure that the information specified in paragraph 1 of this Article are available to the public through appropriate means, such as press, Internet and other media easily accessible.</p> | <p>1.3. Vrednosti procenjenih koncentracija;</p> <p>1.4. Razloge prekoračenja i posebno nekog izvora koji tome doprinosi;</p> <p>1.5. Stanovništvo izloženo takvom prekoračenju.</p> <p>2. Ministarstvo izveštava o svim podacima ocenjenim u skladu sa članom 4 ovog Administrativnog Uputstva, uspostavljanja recipročne razmene informacija i podataka iz mreža i pojedinačnih stanica merući zagađenje okolnog vazduha. Informacije se prenose za svaku kalendarsku godinu, najkasnije do 30 septembra naredne godine.</p> <p>3. Osim zahteva podnetih u stavu 1 ovog člana, Ministarstvo takođe treba da izveštava o merama preduzetim u skladu sa članom 3 ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p>4. Ministarstvo treba da obezbedi da su informacije određenih u stavu 1 ovog člana na raspolaganju javnosti putem pogodnih sredstava kao, štampa, internet kao duge lako dostupne medije.</p> |
|--|--|---|

5. Ministria miraton marrëveshje për përcjelljen e informatave të dhëna sipas paragraf 1 i këtij neni, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 6 këtij Udhëzimi Administrativ.

**Neni 7  
Informimi i publikut**

1. Ministria duhet të sigurojë që informata për përqendrimet e arsenit, kadmiumit, nikelit, merkurit benzo (a) pyrene dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor, referuar në nenin 4 paragrafi 8 këtij Udhëzimi Administrativ, si dhe për normat e depozitimit të, arsenit, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe benzo (a) pyrene dhe hidrokarburet aromatike policiklike referuar në nenin 4 paragrafi 8 këtij Udhëzimi Administrativ të jetë e qarte e kuptueshme dhe e arritshme, në dispozicion të publikut dhe të organizatave relevante mjedisore, organizatat e konsumatorëve, organizatat që përfaqësojnë interesat e grupeve të ndjeshme të popullatës si dhe organet e tjera relevante për mbrojtjen e shëndetit.

2. Informata duhet të tregojë çdo tejkalim vjetor të vlerave të synuara për arsen, kadmium, nikel dhe benzo (a) pyrene të përcaktuara në

5. The Ministry approves agreement to transmit the information provided under paragraph 1 of this Article, in accordance with the procedures set forth in Article 6 of this Administrative Instruction.

**Article 7  
Public information**

1. The Ministry shall ensure that information on concentrations of arsenic, cadmium, nickel, mercury benzo (a) pyrene and polycyclic aromatic hydrocarbons in ambient air referred to in Article 4, paragraph 8 of this Administrative Instruction, and deposit rates of arsenic, cadmium, mercury, nickel and benzo(a)pyrene and polycyclic aromatic hydrocarbons referred to in Article 4, paragraph 8 of this Administrative Instruction shall be clear and understandable, accessible, available to the public and relevant environmental organizations, consumer organizations, organizations representing the interests of sensitive population groups and other relevant bodies for the protection of health.

2. Information shall indicate any annual excess of target values for arsenic, cadmium, nickel and benzo(a)pyrene

5. Ministarstvo usvaja sporazume za praćenje datih informacija prema stavu 1 ovog člana, u skladu sa procedurama određenim u članu 6 ovog Administrativnog Uputstva.

**Član 7  
Informisanje javnosti**

1. Ministarstvo treba da obezbedi da informacije o koncentracijama arsena, kadmijuma, nikla, žive, benzo (a) pirena i policikličnih aromatičnih ugljovodonika u okolnom vazduhu, referišući se na član 4, stav 8 ovog Administrativnog Uputstva, kao i o normama deponovanja arsena, kadmijuma, žive, nikla i benzo (a) pirena i policikličnih aromatičnih ugljovodonika referišući se na tačku 4 stav 8 ovog Administrativnog Uputstva, bude jasno, razumljivo i dostupno, na raspolaganje javnosti i relevantnih organizacija životne sredine, organizacijama potrošača, organizacijama koji zastupaju interese osetljivih grupa stanovništva kao i druge relevantne organe za zaštitu ljudskog zdravlja.

2. Informacija treba da pokaže svako godišnje prekoračenje ciljanih vrednosti za arsen, kadmijum, nikal i benzo (a) piren određenih u

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ. Informata përmban arsytet për tejkalimin e vlerave vjetore të synuara dhe zonën përkatëse. Gjithashtu do të sigurojë një vlerësim të shkurtër në lidhje me vlerat e synuara dhe informata të përshtatshme për ndikimin në shëndet dhe mjedis. Informatat mbi masat e ndërmarra në pajtim me nenin 3 këtij Udhëzimi Administrativ do të vihen në dispozicion për organizatat e referuara në paragrafin 1 i këtij neni.</p> <p>3. Informatat duhet të jenë në dispozicion nepermjet te internetit, shtypit dhe media të tjera lehtësisht të arritshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b><br/><b>Raportimi dhe rishikimi</b></p> <p>1. Ministria raporton Komisionit Evropian për vitin kalendarik paraprak deri me 31. Mars të vitit vijues për:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Përvojat e kërkuara në aplikimin e dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Në veçanti, rezultatet e hulumtimeve të fundit shkencore në lidhje me ndikimin në shëndetin e njeriut, duke i kushtuar vëmendje të veçantë për grupet e</p> | <p>defined in Annex I of this Administrative Instruction. Information contains reasons for exceeding the annual target values and respective area. It will also provide a short assessment related to the target values and appropriate information on the impact on health and the environment. Information on measures taken in accordance with Article 3 of this Administrative Instruction will be available to the organizations referred to in paragraph 1 of this Article.</p> <p>3. Information should be available via the Internet, the press and other media easily accessible.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b><br/><b>Reporting and review</b></p> <p>1. Ministry reports to the European Commission for the previous calendar year up to 31. March of the following year on:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Experience required in applying the provisions of this Administrative Instruction;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. In particular, the results of recent scientific research concerning the effects on human health, paying particular attention to vulnerable</p> | <p>Prilogu I ovog Administrativnog Uputstva. Informacija sadrži razloge prekoračenja godišnjih ciljanih vrednosti i dotično područje. Takođe će obezbediti jednu kratku procenu u vezi sa ciljanim vrednostima i informacijama pogodne za uticaj na ljudsko zdravlje i životnu sredinu. Informacije o preduzetim merama u skladu sa članom 3 ovog Administrativnog Uputstva staviće se na raspolaganje za organizacije referisane u stavu 1 ovog člana.</p> <p>3. Informacije trebaju biti na raspolaganje putem internet, štampe i drugih lako dostupnih medija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b><br/><b>Izveštavanje i revizija</b></p> <p>1. Ministarstvo izveštava Evropsku Komisiju za prethodnu kalendarsku godinu do 31. Marta naredne godine o:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Traženim iskustvima u primeni odredbi ovog Administrativnog Uputstva;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Posebno, rezultate najnovijih naučnih istraživanja u vezi uticaja na ljudsko zdravlje, posebno obraćajući pažnju na ugrožene grupe stanovništva i životnu</p> |
|--|---|---|



|  |  |  |
|--|--|--|
| <p>ndjeshme të popullates dhe mjedisit, të ekspozimit ndaj arsenit, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër;</p> <p>1.3. Zhvillimet teknologjike duke përfshirë progresin e arritur në metodat e matjes ose vlerësimit të përqendrimit të këtyre ndotësve në ajrin mjedisor si dhe depozitim të tyre.</p> <p>2. Raporti i referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të ketë parasysh:</p> <p>2.1. Trendet dhe parashikimet aktuale të cilësisë së ajrit, deri dhe pas vitit 2020;</p> <p>2.2. Qëllimin për të bërë reduktime të mëtejshme të emisioneve ndotëse nga të gjitha burimet relevante, dhe kontributin e mundshëm për prezantimin e vlerave kufitare që synojnë reduktimin e rrezikut për shëndetin e njeriut, për ndotësit e listuar në Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ, duke marrë parasysh fizibilitetin teknik dhe kosto-efektivitetin që do të sigurojë mbrojtje të vecantë të shëndetit të njeriut;</p> | <p>groups of population and environmental exposure to arsenic, cadmium, mercury, nickel and polycyclic aromatic hydrocarbons in the air;</p> <p>1.3. Technological developments including the progress achieved in methods of concentration measurement or assessment of such pollutants in ambient air and their deposition.</p> <p>2. The report referred to in paragraph 1 of this Article shall take into account:</p> <p>2.1. Current trends and projections of air quality until 2020 and thereafter;</p> <p>2.2. Intention to make further reductions of polluting emissions from all relevant sources, and potential contribution to the introduction of limit values aimed at reducing the risk to human health, for the pollutants listed in Annex I of this Administrative Instruction, taking into account the technical feasibility and cost-effectiveness that would provide special protection to human health;</p> | <p>sredinu od izlaganja arsena, kadmijuma, žive, nikla i policiklične aromatične ugljovodonike u vazduhu;</p> <p>1.3. Tehnološke razvoje uključujući napredak postignut u metodama merenja ili procene koncentracije ovih zagađivača u okolnom vazduhu kao i njihovo deponovanje.</p> <p>2. Izveštaj referisan u stavu 1 ovog člana, imaće u vidu:</p> <p>2.1. Trendove i trenutna predviđanja o kvalitetu vazduha, do i posle 2020 godine;</p> <p>2.2. Svrhu da bi se uradile daljnje redukcije emisije zagađivača iz svih relevantnih izvora, i mogući doprinos za prezentiranje graničnih vrednosti koji u cilju smanjenja opasnosti po ljudsko zdravlje, za zagađivače koji su navedeni u listi Priloga I ovog Administrativnog Uputstva, uzimajući u obzir tehnički fizibilitet i isplatljivost koji će obezbediti posebnu zaštitu ljudskog zdravlja;</p> |
|--|--|--|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p>2.3. Marrëdhëniet ndërmjet ndotësve dhe mundësitë për strategjitë e kombinuara për përmirësimin e cilësisë së ajrit të popullatës dhe objektivave të ndërlidhura;</p> <p>2.4. Kërkesat aktuale dhe të ardhshme për informimin e publikut dhe për shkëmbimin e informatave ndërmjet Ministrisë dhe Komisionit Evropian;</p> <p>2.5. Përvojat e fituara në zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ, dhe në veçanti kushtet nën të cilat matja është kryer siç parashtrohet në Shtojcën III të këtij Udhëzimi Administrativ;</p> <p>2.6. Përfitimet sekondare ekonomike për shëndetin e njeriut dhe mjedisin në reduktimin e emisioneve të arsenit, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarburet aromatike policiklike deri në nivelin që këto mund të vlerësohen;</p> <p>2.7. Përshtatshmërinë e fraksionit të madhësisë së grimcave të përdorura për marrjen e mostrave në funksion të kërkesave të përgjithshme për matjen e grimcave;</p> | <p>2.3. Relations between pollutants and opportunities for combined strategies in improving air quality for population and related objectives;</p> <p>2.4. Current and future requirements for public information and for the exchange of information between the Ministry and the European Commission;</p> <p>2.5. Experiences gained in the implementation of this administrative instruction, and in particular the conditions under which the measurement is carried out as set out in Appendix III of this Administrative Instruction;</p> <p>2.6. Secondary economic benefits for human health and the environment in reducing emissions of arsenic, cadmium, mercury, nickel and polycyclic aromatic hydrocarbons to the extent that these can be assessed;</p> <p>2.7. Adequacy of the particle size fraction used for sampling in view of general requirements for measuring particles;</p> | <p>2.3. Odnosi između zagađivača i mogućnosti za kombinovane strategije za poboljšavanje kvaliteta vazduha stanovništva i povezanih ciljeva;</p> <p>2.4. Trenutni i budući zahtevi za informisanje javnosti i razmenu informacija između Ministarstva i Evropske Komisije;</p> <p>2.5. Iskustva stečena u sprovođenju ovog Administrativnog Uputstva, i posebno uslova pod kojima je merenje sprovedeno kako je navedeno u Prilogu III ovog Administrativnog Uputstva;</p> <p>2.6. Sekundarne ekonomske dobiti po ljudsko zdravlje i životnu srednu u smanjenju emisija arsena, kadmijuma, žive, nikla i policikličnih aromatičnih ugljovodonika do nivoa gde se one mogu proceniti;</p> <p>2.7. Prilagodljivost frakcije veličine čestica korišćenih za uzorkovanje u pogledu opštih zahteva za merenje čestica;</p> |
|---|--|---|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>2.8. Përshtatshmërinë e benzo (a) pyrenit si një shënues për aktivitetin total kancerogjen të hidrokarbureve aromatike policiklike, duke pasur parasysh format kryesisht të gazta të hidrokarbureve policiklike aromatike si fluorantheni. Në kuadër të hulumtimeve shkencore dhe teknologjike Ministria do të shqyrtojë gjithashtu edhe efektin e arsenit, kadmiumit nikelit në shëndetin e njeriut me synimin për të kuantifikuar karcinogjenitetin e tyre gjenotoksik.</p>                                    | <p>2.8. Suitability of benzo (a) pyrene as a marker for the total carcinogenic activity of polycyclic aromatic hydrocarbons, considering mainly gaseous forms of polycyclic aromatic hydrocarbons such as fluoranthene. In the context of scientific and technological research, the Ministry shall also examine the effect of arsenic, cadmium and nickel on human health with a view to quantifying their genotoxic carcinogenicity.</p>                  | <p>2.8. Prilagodljivost benzo (a) pirena kao markera za ukupnu kancerogenu aktivnost policikličnih aromatičnih ugljovodonika, imajući u obzir uglavnom gasovite forme policikličnih aromatičnih ugljovodonika kao fluoranten. U okviru naučnih i tehničkih istraživanja Ministarstvo će razmotriti takođe i efekat arsena, kadmijuma, nikla na ljudsko zdravlje sa ciljem kvantifikacije genotoksične kancerogenosti.</p>   |
| <p>3. Në përputhje me Strategjinë e merkurit të Komisionit Evropian, Ministria shqyrton mundësinë e marrjes së masave në lidhje me merkurin, duke marrë parasysh fizibilitetin teknik, kosto-efektivitetin dhe mbrojtje të veçantë të shëndetit të njeriut.</p>   | <p>3. In accordance with the mercury strategy of the European Commission, the Ministry shall review taking action in relation to mercury, considering technical feasibility, cost-effectiveness and the special protection of human health.</p>   | <p>3. U skladu sa Strategijom žive Evropske Komisije, Ministarstvo razmatra mogućnost preduzimanja mera u vezi sa živom, imajući u obzir tehnički fizibilitet, isplatljivost i posebnu zaštitu ljudskog zdravlja.</p>   |
| <p>4. Për të arritur nivelet e përqëndrimeve në ajër që do të zvogëlojnë ndikimet e dëmshme në shëndetin e njeriut dhe do të shpije në një nivel të lartë mbrojtjen e mjedisit, duke marrë parasysh fizibilitetin teknik dhe kosto-efektivitetin e veprimit të mëtejshëm. Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shoqërohet me propozime për ndryshimin e këtij Udhëzimi Administrativ, veçanërisht duke marrë parasysh rezultatet e arritura në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Ministria merr</p> | <p>4. To achieve the levels of concentrations in air that will reduce harmful effects on human health and leads to a high level of environmental protection, taking into account technical feasibility and cost-effectiveness of further action. The report referred to in paragraph 1 of this Article may be accompanied by proposals for amendment of this administrative instruction, especially considering the results obtained in accordance with</p> | <p>4. Da bi se postigli nivoi koncentracije u vazduhu koji će smanjiti štetne uticaje na ljudsko zdravlje i voditi ka visokom nivou zaštite životne sredine, imajući u obzir tehnički fizibilitet i isplatljivost dalje aktivnosti. Izveštaj iz stave 1. ovog člana, može se pridružiti sa predlozima za izmenu ovog Administrativnog Uputstva, posebno imajući u obzir rezultate postignute u skladu sa stavom 2 ovog člana, Ministarstvo uzima u obzir regulisanje deponovanja arsena, kadmijuma, žive, nikla i policikličnih</p> |

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>parasysh rregullimin e depozitimit të arsenit, kadmiumit, mërkurit, nikelit dhe hidrokarburevve aromatike policiklike specifike në ajër.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9<br/>Shtojcat</b></p> <p>Shtojcat I, II, III, IV dhe V janë pjesë përbërëse të këtij Udhëzim Administrativ.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10<br/>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri.</p> <p style="text-align: right;">Hashim Thaçi</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>Kryeministër i Republikës së Kosovës</b></p> <p style="text-align: right;"><b>09.01.2014</b></p> | <p>paragraph 2 of this Article, the Ministry takes into account the regulation of depositing arsenic, cadmium, mercury, nickel and specific polycyclic aromatic hydrocarbons in air.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9<br/>Anexes</b></p> <p>The Anexes I, II, III, IV and V are an integral part of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10<br/>Entry into force</b></p> <p>This Administrative Instruction enters into force seven (7) days after signature by the Prime Minister.</p> <p style="text-align: right;">Hashim Thaçi</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>Prime Minister of the Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: right;"><b>09.01.2014</b></p> | <p>aromatičnih ugljovodonika u vazduhu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9<br/>Prilozi</b></p> <p>Prilog I, II, III, IV, i V su sastavni deo ovog Administrativnog Uputstva</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10<br/>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana od potpisivanja od Premijera.</p> <p style="text-align: right;">Hashim Thaçi</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>Premijer Republike Kosovo</b></p> <p style="text-align: right;"><b>09.01.2014</b></p> |
|---|--|--|

## SHTOJCA I

### Vlerat e synuara për arsen, kadmium, nikel dhe benzo (a) pyren

| Ndotësi  | Vlera e synuar (*)   |
|--|----------------------|
| Arsen  | 6 ng/m <sup>3</sup>  |
| Kadmium  | 5 ng/m <sup>3</sup>  |
| Nikel  | 20 ng/m <sup>3</sup> |
| Benzo(a)pireni   | 1 ng/m <sup>3</sup>  |
| (*) Për përmbajtjen totale në grimcat PM <sub>10</sub> mesatarisht gjatë vitit kalendarik. |                      |

## SHTOJCA II

### Përcaktimi i kërkesave për vlerësimin e përqendrimeve të arsenit, kadmiumit, nikelit dhe benzo (a) pyrenit në ajrin mjedisor brenda një zonë ose aglomerati

#### I. Pragjet e ulëta dhe të larta të vlerësimit

|   | Arsen                            | Kadmium                        | Nikel                           | Benzo(a)piren                  |
|---|----------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|--------------------------------|
| Pragu i lartë I vlerësimit në përqindje të vlerës së synuar | 60 %<br>(3.6 ng/m <sup>3</sup> ) | 60 %<br>(3 ng/m <sup>3</sup> ) | 70 %<br>(14 ng/m <sup>3</sup> ) | 60<br>(0.6 ng/m <sup>3</sup> ) |

|  |                                  |                                  |                                  |                                  |
|--|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| Pragu i ulët i vlerësimit në përqindje të vlerës së synuar | 40 %<br>(2.4 ng/m <sup>3</sup> ) | 40 %<br>(2.4 ng/m <sup>3</sup> ) | 50 %<br>(2.4 ng/m <sup>3</sup> ) | 40 %<br>(2.4 ng/m <sup>3</sup> ) |
|--|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|

## II. Përcaktimi i tejkalimit për pragjet e epërme dhe të ulët të vlerësimit

Tejkalimi i pragut të epërm dhe të poshtëm të vlerësimit duhet të përcaktohet në bazë të përqendrimeve gjatë pesë viteve të mëparshme, ku të dhënat e mjaftueshme janë në dispozicion. Pragu i vlerësimit do të konsiderohet se është tejkaluar në qoftë se ka qenë i tejkaluar të paktën gjatë tri viteve kalendarike nga pesë vitet e mëparshme.

Kur janë në dispozicion të dhënat më pak se pesë vjet, MMPH mund të kombinojë kampanjat e matjeve me kohëzgjatje të shkurtër gjatë periudhës të vitit dhe në lokacione që mund të jenë representative të niveleve më të larta të ndotjes, me rezultate të perfituara nga informatat e inventarëve të emisioneve dhe të modelimit, për përcaktimin e tejkalimit të pragjeve të epërme dhe të ulët të vlerësimit.

## SHTOJCA III

### Lokacioni dhe numri minimal i pikave mostruese për matjet e përqendrimeve në ajrin mjedisor si dhe shkalla e depozitimit

#### I. Pozicionimi i makronivelit

Pikat mostruese duhet të lokalizohen në atë mënyrë që:

— të ofrojnë të dhëna në rajonet brenda zonave apo aglomerateve ku popullata ka gjasa të ekspozohet në mënyrë direkte apo indirekte përqendrimeve të mëdha për një periudhë mesatare gjatë vitit kalendarik.

- të ofrojnë të dhëna rreth niveleve në rajonet tjera brenda zonave apo aglomerateve që janë reprezentative të ekspozimit të popullatës së përgjithshme.

— të ofrojnë të dhëna mbi shkallen e depozitimit që përfaqësojnë ekspozim jo të drejtpërdrejtë të popullatës përmes zinxhirit ushqimor.

Pikat mostruese në përgjithësi duhet të vendosen ashtu që të shmangen matjet mikro-mjedisore, në rrethinën e drejtpërdrejt, që do të thotë që pika mostruese duhet të vendoset në një mënyrë që të jetë reprezentative e cilësisë së ajrit në zonat perreth jo më pak se 200 m<sup>2</sup> gjatësi në pikat e orientuara nga trafiku dhe së paku 250m x 250 m në zonat industriale, ku është e mundur ,dhe disa kilometra katror në zonat me prapavije urbane.

Ku si objektive është të vlerësohen nivelet e prapavijës pikat mostruese nuk duhet të ndikohen nga aglomeratet ose zonat industriale në afërsi, psh. lokacionet më afër se disa kilometra.

Aty ku duhet të vlerësohen kontributet nga burimet industriale, së paku një pikë mostruese duhet të instalohet në drejtim të erës nga burimi në zonën më të afërt të banimit.Ku përqëndrimi i prapavijës nuk është i njohur, duhet të vendoset një pikë mostruese shtesë, përbrenda drejtimit kryesor të erës. Në veçanti, ku Neni 3 (3) zbatohet, pikat mostruese duhet të instalohet që aplikimi i BAT mund të monitorohet . Pikat mostruese gjithashtu aty ku është e mundur, duhet të jenë reprezentative të lokacioneve të ngjashme jo në rrethinën e drejtpërdrejtë të tyre. Aty ku është e përshtatshme duhet të jenë bashkë-vendosur me pikat mostruese për PM<sub>10</sub>.

## II. Pozicionimi i mikronivelit

1. Kriteriet në vijim duhet të zbatohen në shkallën më të lartë :

- rrjedhja përreth sondës hyrëse të aparatit të marrjes së mostrave duhet të jetë pa pengesa , pa ndonjë pengesë që do të ndikonte në rrjedhjen e ajrit në afërsi të aparatit të marrjes së mostrës(zakonisht disa metra larg ndërtesave, ballkoneve, drunjëve dhe pengesave tjera dhe së paku 0.5 m larg ndërtesës më të afërt, në rastin kur pikat mostruese përfaqësojnë cilësinë e ajrit në linjën e ndërtesave);
- në përgjithësi pika hyrëse e marrjes së mostrave duhet të jetë midis 1.5 m (zona e frymëmarrjes) dhe 4 m mbi tokë. Pozitat më të larta (deri në 8 m) mund të jenë të domosdoshme në disa raste. Pozicionimi më i lartë mund të jetë i përshtatshëm nëse stacioni është reprezentativ i një zone më të madhe;
- sonda hyrëse - nuk duhet të pozicionohet në afërsi të drejtpërdrejtë të burimit ndotës në mënyrë që të shmangët futja direkte e emisionit pa përzierje me ajrin mjedisor;

- dalja e tubit të shkarkimit të aparatit të marrjes së mostrave duhet të pozicionohet në atë mënyrë që të shmanget riqarkullimi i ajrit shkarkues në lokacionin hyrës të mostrës;
- lokacioni i pikave mostruese për monitorimin e ndotjes nga trafiku duhet të jetë së paku 25 m nga skaji i udhëkryqeve kryesore dhe së paku 4 m nga trotuari. Sondat duhet të vendoset që të jenë reprezentative për cilësinë e ajrit afër linjës së ndërtesave;

2. Faktorët në vijim që duhet gjithashtu të merren në konsideratë:

- burimet interferuese,
- siguria,
- qasja,
- vënia në dispozicion e energjisë elektrike dhe komunikimi telefonik,
- dukshmëria e lokacioneve në varësi nga ambienti rrethues,
- siguria e publikut dhe operatorëve,
- preferenca e bashkëvendosjes së pikës së përzgjedhjes së mostrave për ndotësit e ndryshëm,
- kërkesat e planifikuara.

### **III. Dokumentimi dhe rishikimi i përzgjedhjes së lokacioneve**

**1. Procedurat e përzgjedhjes së lokacioneve të pikave matëse duhet të dokumentohen plotësisht në fazën klasifikuese me mjete si fotografitë e bëra, me busollë në rajonin përreth dhe hartat e detajizuara. Lokacionet duhet të rishikohen në intervale të rregullta me dokumentacion të përsëritur në mënyrë që të sigurohemi se kriteriet e përzgjedhjes mbeten valide gjatë kohës.**

### **IV. Kriteret për përcaktimin e numrit të pikave të marrjes së mostrave për matjet fikse për përqendrime të arsenit, kadmiumit, nikelit dhe benzo (a) pyrenit në ajrin mjedisor**

Numri minimal i pikave për marrjen e mostrave për matje fikse për të vlerësuar pajtueshmërinë me vlerat e synuara për mbrojtjen e shëndetit të njeriut në zonat dhe aglomeratet ku matja fikse është i vetmi burim i informacionit.



## 1. Burimet difuzeve

| Popullimi i aglomeratit ose zonës (mijëra) | Nëse përqendrimet maksimale tejkalojnë pragun e lartë të vlerësimit* |       | Nëse përqendrimet maksimale janë ndërmjet pragjeve të ulëta dhe të larta të vlerësimit |       |
|--|--|-------|--|-------|
|  | As, Cd, Ni   | B(a)P | As, Cd, Ni   | B(a)P |
| 0-749                                      | 1  | 1     | 1  | 1     |
| 750 – 1999                                 | 2  | 2     | 1  | 1     |
| 2000 – 3749                                | 2  | 3     | 1  | 1     |
| 3750 - 4749                                | 3  | 4     | 2  | 2     |
| 4750 - 5999                                | 4  | 5     | 2  | 2     |
| > 6 000                                    | 5  | 5     | 2  | 2     |

\* Të përfshihet së paku një stacion me prapavijë urbane dhe për benzol (a) pyrene, po ashtu një stacion me orientim trafiku me kusht që të mos rritet numri i pikave të marrjes së mostrave.

## 2. Vendburimet

Për vlerësimin e ndotjes në afërsi të vendburimeve, numri i pikave për marrjen e mostrave për matje fikse, duhet të përcaktohet duke marrë parasysh densitetin e emisionit, modelet e mundshme të shpërndarjes së ndotjes së ajrit mjedisor dhe ekspozimit të mundshëm të popullsisë. Pikat e marrjes së mostrave duhet të vendosen ashtu që aplikimi i teknologjisë më të mirë të mundshme (TMM), e përcaktuar në Ligjin për PKIN.

## SHTOJCA IV

### Objektivat e cilësisë së të dhënave dhe kërkesat për modelet e cilësisë së ajrit

#### 1. Objektivat e cilësisë së të dhënave

|                                   | Benzo(a)pireni | Arsen,<br>kadmium<br>dhe nikel | Hidrokarbure<br>aromatike poli<br>ciklike përveç<br>benzo(a)pirenit,<br>merkuri i gazit<br>total | Depozitimi<br>total |
|-----------------------------------|----------------|--------------------------------|--|---------------------|
| - Pasiguria                       |                |                                |  |                     |
| Matjet indikativ dhe fikse        |                |                                |  |                     |
| Modelimi                          | 50%            | 40%                            | 50%  | 70%                 |
| - Marrja e të dhënave<br>minimale | 60%            | 60%                            | 60%  | 60%                 |
| - Koha minimale e<br>mbulimit :   | 90%            | 90%                            | 90%  | 90%                 |
| Matjet fikse                      | 33%            | 50%                            |  |                     |
| Matjet indikative*                | 14%            | 14%                            | 14%  | 33%                 |

\* Matjet indikative, duke qenë matje që kryhen në rregull të reduktuar, por që plotësojnë objektivat tjera të cilësisë së të dhënave.

Pasiguria (e shprehur në një nivel të besueshmërisë prej 95%) e metodave të përdorura për vlerësimin e përqendrimeve të ajrit mjedisor do të vlerësohet në pajtim me parimet e Udhëzuesit CEN për shprehjen e pasigurisë në matje (ENV 13005:1999), metodologjia e ISO 5725:1994, dhe udhëzimet e ofruara në Raportin CEN, 'Cilësia e ajrit - qasja për vlerësimin e pasigurisë për referencë të metodave të matjes së ajrit mjedisor' (CR 14377:2002 E). Përqindjet e pasigurisë janë dhënë për matje të veçanta, të cilat janë mesatarisht rreth kohës së marrjes së mostrave tipike për një interval të besueshmërisë prej 95%. Pasiguria e matjeve duhet të interpretohet si e zbatueshme në rangun e vlerës së përshtatshme të synuar. Matjet fikse dhe indikative duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë gjatë vitit që të shmanget devijimi i rezultateve.

Kërkesat për marrjen minimale të të dhënave dhe të kohës së raportimit nuk përfshijnë humbjet e të dhënave për shkak të kalibrimit të rregullt ose mirëmbajtjes normale të instrumenteve. Marrja e mostrave njëzetekatërorëshe është e nevojshme për matjen e benzo (a) pyrene dhe hidrokarbure të tjera aromatike policiklike. Mostrat individuale të marra me kujdes gjatë një periudhe deri në një muaj mund të kombinohen dhe analizohen si një mostër e përbërë me kusht që metoda të sigurojë se mostrat janë të qëndrueshme për këtë periudhë. Benzo (b) fluoranthene, benzo (j) fluoranthene, benzo (k) fluroanthene mund të jetë e vështirë për t'i zgjidhur në mënyrë analitike. Në raste të tilla mund të raportohen si shuma. Marrja e mostrave njëzetekatërorëshe është gjithashtu e këshillueshme për matjen e përqendrimeve të arsenit, kadmiumit dhe nikelit. Marrja e mostrave duhet të bëhet në mënyrë të barabartë gjatë ditëve të javës dhe të vitit. Për matjen mujore apo javore të normave të depozitimit, rekomandohen mostrat gjatë gjithë vitit.

Vetëm marrja e mostrave të lagëta mund të përdoret në vend të marrjes së mostrave në masë, në qoftë se mund të demonstrohet se dallimi në mes tyre është brenda 10%. Normat e depozitimit në përgjithësi duhet të jepen si  $\mu\text{g}/\text{m}^2$  në ditë.

Koha minimale e mbulimit më të ulët sesa paraqitet në tabelë, mund të aplikohet, por jo më pak se 14% për matjet fikse dhe 6% për matje indikative, me kusht që të mund të demonstrohet se 95%, e pasigurisë për mesatare vjetore e llogaritur nga objektivat e cilësisë së të dhënave në tabelë sipas ISO 11222:2002 - duhet të përmbushet "Përcaktimi i pasigurisë i mesatares kohore për matje të cilësisë së ajrit".

## **2. Kërkesat për modele të cilësisë së ajrit**

Kur shfrytëzohet një model i cilësisë së ajrit për vlerësim, duhet të përpilohen referencat për përshkrimet e modelit dhe informacionit rreth pasigurisë. Pasiguria për modelim është përcaktuar si devijim maksimal i niveleve të matura dhe të kalkuluara gjatë një viti të plotë, pa marrë parasysh kohën e ngjarjeve.

## **3. Kërkesat për teknikat e vlerësimit objektiv**

